



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 85, Datë 20.04.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGE SUNPOWER” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
TOPOJË (SHEQ MARINAS) ME FUQI TË INSTALUAR 2000 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 13, nenit 14 pika 2, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; ”, nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “Age Sunpower” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 2000 KW,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr.110 Prot, datë 26.01.2018, shoqëria “Age Sunpower” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Centrali Fotovoltaiik Topojë (Sheq Marinas).
- Në datën 12.10.2017, është lidhur Kontrata me nr. 2272 Rep. dhe 1051/3 Kol, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaiik “Topojë” me kapacitet të instaluar 2000 KW; në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bajtësit të miratimit përfundimtar, shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me miratimin përfundimtar nr. 5789/2, datë 11.09.2017, ka miratuar ndërtimin e Centralit Fotovoltaiik Topojë në favor të “Age Sunpower” sh.p.k, me fuqi të instaluar 2000 KW, në koordinatat e përcaktuara në nenin 3 të Kontratës së sipërcituar.

- Bordi i ERE me vendimin nr. 32, datë 09.02.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Age Sunpower” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 2000 KW.
- Me shkresën me nr. 55/4 Prot., datë 09.02.2018, është bërë njoftimi në median e shkruar lidhur me fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me fuqi të instaluar 1998 KW, me vendodhje Fshati Topojë, qarku Fier. Mbas përfundimit të afatit të përcaktua për paraqitjen e objeksioneve ose ankesave, lidhur për sa publikuar, nuk rezulton të jenë paraqitur në ERE, ankesa dhe objeksione nga palët e treta.
- Me shkresën nr. 110/3 Prot, datë 23.02.2018, ERE i është drejtuar subjektit “AGE Sunpower” sh.p.k, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Aplikuesi, në referencë të *“Rregullores për procedurat afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* përkatësisht neni 9 pika 4.4.4 gërma “c“, ka depozituar në ERE shkresën me nr. 29 Prot., datë 17.04.2018 *“Oponenca Teknike e Projektit”*.
- Subjekti me shkresën me nr. 26 Prot, datë 12.03.2018 (dërgim dokumentacioni në ERE), prtokolluar me tonën nr. 110/3 Prot, datë 12.03.2018, ka paraqitur në ERE për sqarime më konkrete në lidhje me dokumentacionin dhe gjithashtu në datë 27.03.2018, me shkresën e protokolluar me tonen me nr. 110/7 Prot., datë 28.03.2018, subjekti ka depozituar në ERE dokumentacionin referuar kërkesës së ERE-s.
- Aplikimi i shoqërisë “Age Sunpower” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3 (gërmat “a”, ”b”, “c”, “d”); 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Age Sunpower” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 2000 KW, për një afat 20 - vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI